

**FORMULAR PËR PËRFAQËSUESIT E MEDIAS**  
**KËRKESË PËR REGJISTRIMIN/TRANSMETIMIN E IMAZHEVE FILMIKE TË SEANCËS**  
**GJYQËSORE**

Bazuar në vendimin nr. 716, datë 06.12.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor “Për miratimin e udhëzuesit standard të marrëdhënieve të gjykatave me publikun dhe median”

<b>TË DHËNAT E PËRFAQËSUESIT TË MEDIAS</b>		
<b>Emër Mbiemër:</b> Z./Znj.	<b>Adresa postare:</b> <b>Adresa elektronike:</b> <b>Nr. Tel:</b>	<b>Data e kërkesës:</b>

<b>TË DHËNAT E SEANCËS GJYQËSORE</b>		
<b>Data e seancës</b>	<b>Palët</b>	<b>Gjyqtari</b>

<b>Regjistrim i imazheve filmike të seancës gjyqësore</b>	<input type="checkbox"/>
<b>Regjistrim dhe transmetim i drejtpërdrejtë i imazheve filmike të seancës gjyqësore</b>	<input type="checkbox"/>
<b>Fotografimi i seancës gjyqësore</b>	<input type="checkbox"/>

**Parimet e Marrëdhënies të publikut dhe median**

Marrëdhënia e gjykatës me publikun dhe median bazohet në parimet e aksesit të barabartë në gjykata, karakterit publik të procesit gjyqësor, hapjes maksimale të veprimtarisë gjyqësore ndaj shoqërisë përmes komunikimit me publikun, **së drejtës së informimit, mbrojtjes së dinjitetit njerëzor, privatësisë dhe të dhënave personale, reputacionit si dhe prezumimit të pafajësisë.**

Seancat gjyqësore publike janë të hapura për publikun dhe median. Përfaqësuesit e medias mund të ndjekin procesin gjyqësor **pa bërë komente dhe brenda rregullave që diktohen nga gjyqtari/kryesuesi i trupit gjykues për zhvillimin e gjykimit të drejtë.**

Përfaqësuesi i medias, gjatë seancës, **lejohe të raportojë përmes pajisjeve telefonike dhe/ose, kompjuterike dhe të dërgojë mesazhe të shkruara përmes tyre.** Në çdo rast këto pajisje duhet të përdoren pa zë.

Gjyqtari/kryesuesi i trupit gjykues **me urdhër mund të kufizojë ose të ndalojë përdorimin e pajisjeve telefonike dhe/ose kompjuterike apo pajisje të tjera gjatë seancës** nëse përdorimi i tyre pengon administrimin e duhur të drejtësisë ose rendin dhe rregullin e procesit gjyqësor.

Seancat gjyqësore **mund të regjistrohen dhe transmetohen në media me kërkesë të mediave ose me nismën e gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjykues.** Në çdo rast, regjistrimi dhe transmetimi i seancës, tërësisht ose pjesërisht, bëhet vetëm kur nuk bie ndesh me rregullat e procesit të rregullt ligjor.

Media elektronike mund të regjistrojë dhe transmetojë, tërësisht ose pjesërisht, me urdhër të gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjykues, i cili vendos për çështjen objekt gjykimi. Çdo regjistrim tjetër është i ndaluar.

Kërkesa për pjesëmarrje i paraqitet nëpunësit për marrëdhëniet me publikun dhe median jo më vonë se njëzet e katër orë para orës së deklaruar për fillimin e seancës gjyqësore.

Gjyqtari/ kryesuesi i trupit gjykues ka të drejtën të: a) lejojë ose të ndalojë regjistrimin dhe transmetimin e plotë të seancës; b) lejojë ose ndalojë regjistrimin e pjesshëm të seancës; c) ndalojë transmetimin e pamjeve specifike gjatë një seance dëgjimore që ishte lejuar më parë të regjistrohej.

Kërkesa pranohet ose refuzohet plotësisht ose pjesërisht vetëm në çelje të seancës gjyqësore, kur të pranishëm në sallë janë edhe përfaqësuesit e medias që bën kërkesën. Kjo pjesë e seancës është e regjistrueshme dhe transmetohet pa asnjë kufizim.

Kërkesa mund të refuzohet vetëm për këto arsye: a) Seanca gjyqësore zhvillohet me dyer të mbyllura. b) Kur një nga subjektet në gjykim nuk dëshiron të regjistrohet seanca. Ky rregull nuk vlen për prokurorin dhe avokatin. c) Çmohet nga gjyqtari/kryesuesi i trupit gjykues se prania e kamerave ndikon ecurinë e procesit të rregullt gjyqësor.

Për të siguruar rendin e duhur të procesit, gjykata mund të vendosë që t'i lejohet aksesimi në sallë një numri të kufizuar ekipesh me kamera dhe të përcaktojë si kusht që ata të jenë pjesë në një skemë shpërndarjeje tek të tjerët që nuk kanë akses. Kamerat vendosen gjithmonë në fund të sallës dhe në mënyrë statike. Ndalohet përdorimi i tyre në mënyrë të lëvizshme.

Kur seanca gjyqësore regjistrohet me kamera nga vetë gjykata, kamerat e medias elektronike nuk lejohen të filmojnë. Në këtë rast, shërbimi i marrëdhënieve me median dhe publikun nën drejtimin e gjyqtarit/kryesuesit të trupit gjykues, shpërndan pamjet filmike dhe/ose audio nga seanca, ose lejon transmetimin e plotë të saj nga mediat të vendosura nga një mjedis i posaçëm jashtë sallës së gjyqit që administrohet nga ky shërbim.